



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0659

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

NTP "G", me seli në fshatin K, Komuna e Vitisë, me pronar S I.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-20-0061 të datës 15 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-20-0061 i datës 15 nëntor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 14 janar 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI067-0017 të datës 11 dhjetor 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për pagesën e faturave të pa paguara të datës 31

gusht 2006 dhe 30 shtator 2006, në shumë prej 8,483.43 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar pasi që kërkesa duhet të ishte paraqitur në Gjykatë apo në ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve, nga momenti kur NSH NSH OP "G", pretendohet të mos ketë kryer obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare, e që është 3 vjet nga 30.09.2006, kur parashtruesi nuk e ka pranuar pagesën e faturave.

Në padinë e parashtruar ka theksuar se kreditori ka qenë në raport të rregullt afarist me debitorin, ku nga ky bashkëpunim debitori ka mbetur në detyrime tek kreditori një shumë prej 8,483.43 euro, për katër fatura të vitit 2006, dhe se pagesa nuk është bërë për shkak se NSH-ja ka hyrë në proces të privatizimit. Padiësi ka shtuar se AKP-ja e ka sjellë në lajthim kreditorin duke lëshuar letër pezullimet për punëtorët, për shkak të privatizimit të Ndërmarrjes. Me padi është propozuar që padiësit t'i njihet e drejta në kërkesën kreditore prej 8,483.43 euro për borxhin e evidentuar në katër fatura të vitit 2006. Bashkë me padinë është dorëzuar edhe vendimi i AL-së, me të cilin është refuzuar kërkesa kreditore, një deklaratë e F H, Fatura 19/2006, e datës 31 gusht 2006: fatura 20/2006 e datës 31 gusht 2006, Fatura 22/2006, e datës 30.09.2006, Fatura 23/2006, e datës 30 shtator 2006, pasqyra e qarkullimit të llogarisë bankare për padiësin NTP" G:, për periudhën 01.01.2005-31.12.2006, e lëshuar nga Banka NLB Prishtina.

Me 08 prill 2016, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja ka theksuar se padiësi nuk ka paraqitur ndonjë marrëveshje të shkruar me Ndërmarrjen, mbi bazën e së cilës do të mund të kërkonte borxhin e pretenduar. AKP-ja ka theksuar se kërkesa është parashkruar, konform nenit 374 të LMD-së, e cila dispozitë rregullon parashkrimin e kërkesave kur të dy subjekte janë persona juridik, siç kemi të bëjmë me rastin konkret. Po ashtu AKP-ja ka theksuar se nuk ka pasur asnjë veprim nga pala ndërgjyqjese që do të shkaktonte ndërprerjen e parashkrimit.

Më 11 korrik 2016, padiësi ka dorëzuar përgjigjen ndaj mbrojtës së AKP-së, ku kryesisht ka përmbajtje të deklarime të mëhershme. Në parashtresë padiësi ka theksuar se borxhi është pohuar në vazhdimësi nga Ndërmarrja dhe nga Agjencia

dhe vazhdimisht i është thënë paditësit që kërkesën ta paraqesë pas hyrjes së Ndërmarrjes në Likuidim.

Më 04 gusht 2016, e paditura ka paraqitur kundërpërgjigje, ku nder të tjera ka theksuar se AKP-ja nuk mund të jetë palë e paditur, pasi i mungon legjitimiteti real pasiv, gjë që paditësi ka shkelur edhe dispozitat e nenit 18.2 të Ligjit për AKP-në, ku është përcaktuar se "Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi veprimi ose mosveprimi, që i atribuohet një Ndërmarrje".

Pas përfundimit të procedurave me shkrim, Kolegji i Specializuar ka mbajtur seanca dëgjimore me palët në procedurë.

Më 28 mars 2018, Kolegji i Specializuar IV i Dhomës së Posaçme ka nxjerr aktgjykimin me të cilin e ka miratuar kërkesëpadinë. Më 03 shtator 2020, Kolegji i Apelit pranë Dhomës së Posaçme, në procedurë ankimore e ka anuluar aktgjykimin e Kolegji i Specializuar IV dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Me 15 nëntor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-20-0061 e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka Vërtetuar vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI067-0017, të datës 11.12.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në arsyetim të Aktgjykimit thuhet se kërkesa padia nuk është e bazuar në Ligj pasi siç është parë nga përmbajtja e faturave ato janë lëshuara në vitin 2006, ndërsa kërkesa kreditore është paraqitur me datën 05.11.2013. Shkalla e I-rë, ka konstatuar se është jo kontestuese se mes palëve se NSH-ja është privatizuar në vitin 2006, vit ky kur iu ka pushuar marrëdhënia e punës të gjithë punëtoreve të Ndërmarrjes, ndërsa likuidimi i Ndërmarrjes ka filluar në vitin 2013. Shkalla e I-rë e ka konsideruar si fakt jo kontestues se NSH ka hyrë në procedurë të likuidimit në vitin 2013 dhe se kërkesa kreditore është paraqitur më 05 nëntor 2013. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se në kohën e raportit afarist të pretenduar me kërkesëpadi (viti 2006), ka qenë në fuqi si ligj material LMD i vitit 1978, i cili Ligj, me nenin 374 ka përcaktuar se kërkesat reciproke nga kontrata për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në mes të subjekteve juridikë apo tregtare parashkruhen për tri vite. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë nga qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve të pretenduara nga një

subjekt afarist, ndaj subjektit tjetër afarist, prej nga rrjedh se kërkesa e paditësit është parashkruar. Edhe LMD i vitit 2012 (neni 355), e ka ruajtur afatin e parashkrimit prej tri vitesh, për kërkesat reciproke nga kontrata komerciale.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se fatura e fundit është lëshuar më datën 30 shtator 2006, që do të thotë se afati përfundimtar për pagesat e faturave ishte data 30 tetor 2006. Pastaj, më datën 01 nëntor 2006 ka filluar të rrjedh afati i parashkrimit, dhe se pas tri vitesh të plota, respektivisht me datën 01 nëntor 2009, kërkesa është parashkruar. Po ashtu shkalla e I-rë ka theksuar se objekt i shqyrtimit ka qenë edhe pretendimi i paditësit se NSH-ja dhe stafi i AKP-së e kanë pohuar borxhin e pretenduar dhe se pohimi i borxhit paraqet ngjarje të ndërprerjes së afatit të parashkrimit. Ky pretendim është mbështetur në deklarin e tre dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje kontestimore. Shkalla e I-rë ka theksuar se në seancën dëgjimore të datës 01 shkurt 2018, dëshmitari F H ka deklaruar se ka punuar për NSH-në "Bentokos", si ekonomist në vitet 1986-2006, e cila kishte raport afarist me palën paditëse. Dëshmitari kishte deklaruar se pala paditëse ka kryer shërbime për NSH-në, ku katër fatura të vitit 2006 kishin mbetur të pa paguara, në vlerë prej 8,483.43 euro. Shkalla e I-rë ka vlerësuar se dëshmia e tij nuk e argumenton se gjatë viteve 2006 apo në viteve të mëvonshme ka pasur pohim borxhi apo ndërprerje të aftit të parashkrimit. Gjykata pohon se edhe sikur të kishte pohim borxhi dhe ndërprerje të aftit të parashkrimit, përsëri kërkesa rezulton të jetë parashkruar. Nën supozimin se ka pasur pohim borxhi në vitin 2006 (gjë që nuk është provuar), do të rezultante se parashkrimi ka filluar të rrjedhë përsëri me datën 01.01.2007. Megjithatë, kërkesa do të parashkruhej më 01.01.2010. Siç është potencuar më sipër, kërkesa kreditore është paraqitur tri vite më vonë, përkatësisht në vitin 2013. Shkalla e I-rë ka dëgjuar dy dëshmitaret e tjerë në seancën dëgjimore, S J dhe G Sh, që të dy zyrtarë të AKP-së e kanë kundërshtuar deklarin e dëshmitarit të parë, duke theksuar se nuk i kanë pohuar asnjë herë borxhin e NSH-së dhe nuk kanë pasur një kompetencë të tillë. Prandaj, gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit F H. Shkalla e I-rë ka konstatuar se borxhi ka mundur të pohohet vetëm nga përfaqësuesi ligjor i ndërmarrjes apo nga personi i autorizuar nga ai. Kur kemi të bëjmë me pohimin verbal, duhet të ketë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pohimin e tillë.

Po ashtu shkalla e I-rë ka konstatuar se objekt i shqyrtimit ka qenë edhe pretendimi i paditësit se ndërmarrja është privatizuar në vitin 2006, kure edhe iu ka dërguar punëtorëve 'letër pezullimi', mbi punimin e marrëdhënies së punës, dhe i ka njoftuar që kërkesa tyre mund t'i parashtrinë pranë AL-së, kur të fillojë procedura e likuidimit. Sipas paditësit, edhe këto veprime paraqesin ndërprerje të aftit të parashkrimit, pasi ai ka pritur fillimin e procedurës së likuidimit për të dorëzuar kërkesën kreditore, e cila procedurë nuk ka filluar deri në vitin 2013. Mirëpo gjykata nuk i ka marrë për bazë këto pretendime, sepse AKP-ja asnjëherë nuk e ka konsideruar paditësin si kreditore, nuk ka komunikuar me të dhe nuk i ka dhënë dëshmi njoftimi se NSH-ja është privatizuar apo se duhet pritur fillimin e procesit të likuidimit për të deponuar kërkesën kreditore. Prandaj, gjykata konsideron se paditësi nuk mund të përfitoj nga korrespondenca e AKP-së në relacion me punëtorët e NSH-së, për të përdorur atë si argument të ndërprerjes së aftit të parashkrimit të kërkesës kreditore.

Me 06 dhjetor 2022, paditësi për mes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-20-0061 të datës 15 nëntor 2022, me të cilën ka propozuar që të aprovohet në tersi ankesa e përfaqësuesit të NTP'GODEN" të parashtruar nga pronari i ndërmarrjes S I si e bazuar, të detyrohet e paditura/debitori që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë pagesën e vlerës/rimbursimin prej 8.483.43 euro.

Paditësi/ ankuesi në ankesë ka theksuar se me kohë ka parashtruar faktuarat e shërbimeve të kryera ndaj ndërmarrjes në likuidim për vlerën e shërbimeve të kryera. E paditura/ debitori edhe pse sipas ligjeve pozitive, tek pranimi i borxhit sipas dispozitës të nenit 368/pika 1. Përshkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin pika 2 e pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, por edhe në mënyre të tërthorte, sikurse janë pagesat e këstit pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit/ në harmoni me nenin 373/ pas ndërprerjes nuk llogaritet në aftin ligjor për parashkrim pika 2, pika 4 e lidhur me nenin 369 të Ligjit mbi marrëdhëniet e Detyrimeve Ligjinr.04/L077. Po ashtu paditësi/ ankuesi në ankesë ka theksuar se në rastin konkret kemi pranim të borxhit nga debitori N.SH në likuidim O.P. Bentokosi, ekonomisti i kësaj ndërmarrje në likuidim ka pranuar si me shkrim por edhe në seancën borxhin që ka pasur ndërmarrja debitori ndaj kreditorit prej 8.483,43 euro.

Me 18 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankesë. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 05 Nëntor 2007, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensimin e pagesave të faturave të pa paguara të datës 31 gusht 2006 deri më 30 shtator 2006, në shumën prej 8,483.43 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 374 të Ligjit Per Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përfshihet se kërkesat e tilla parashkruhen për tre vite. Pasi që kërkesa duhet të ishte paraqitur në Gjykatë apo në ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve, nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë kryer obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare, e që është 3 vjet nga 30.09.2006, kur parashtruesi nuk e ka pranuar pagesën e faturave.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar pranë DHPGJS-së kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, i ka kundërshtuar konstatimet e dhëna te Autoritetit të Likuidimit dhe pretendon se ka qenë në raport të rregullt afarist me

debitorin NSH OP''G'', në likuidim, ku nga ky bashkëpunim debitori ka mbetur në detyrime tek kreditori në një shumë prej 8,483.43 euro, për katër fatura të vitit 2006, dhe se pagesa nuk është bërë për shkak se NSH-ja ka hyrë në proces të privatizimit.

Shkalla e I-rë kishte marrë Aktgjykimi me të cilin refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit ashtu që Vërtetohet vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit GJI067-0017, i datës 11.12.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkalles së I-rë se në kohën e raportit afarist të pretenduar nga paditësi (viti 2006), ka qenë në fuqi si Ligj material LMD i vitit 1978, i cili Ligj, me nenin 374 ka përcaktuar se kërkesat reciproke nga kontrata për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në mes të subjekteve juridikë apo tregtare parashkruhen për tri vite. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë nga qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve të pretenduara nga një subjekt afarist, ndaj subjektit tjetër afarist. Fatura e fundit është lëshuar më datën 30 shtator 2006, që do të thotë se afati përfundimtar për pagesat e faturave ishte data 30 tetor 2006. Me 01 nëntor 2006 ka filluar të rrjedh afati i parashkrimit, dhe se pas tri vitesh të plota, respektivisht me datën 01 nëntor 2009, siç ka konstatuara edhe Shkalla e I-rë kërkesa është parashkruar.

Është po ashtu i saktë konstatimi i Shkallës së I- se duke u bazuar ne nenin 506 të LPK-së, është përcaktuar se " Faktet lidhur me qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të cilin e shoqërojnë dokumentet standarde afariste, si rregull provohen me këto dokumente". Prandaj, edhe pohimi i borxhit nëse ka ndodhur duhet të provohet në radhë të parë me dokumentacionin afarist. Paditësi, këto rrethana të pretenduara nuk arritur t'i provojë me asnjë provë. Prandaj, shkalla e I-rë me të drejtë nuk e ka pranuar pretendimin e paditësit se ka pasur ndërprerje të aftit të parashkrimit.

Paditësi edhe me ankesë në Shkallen e II-të vazhdon ta mbështet pretendimin e tij se ka pasur ndërprerja të parashkrimit në bazë të pohimit. Shkalla e I-rë me të drejtë ka vlerësuar se gjatë viteve 2006 apo në vitet e mëvonshme nuk ka pasur pohim borxhi apo ndërprerje të aftit të parashkrimit. Edhe sikur të kishte pohim borxhi dhe ndërprerje të aftit të parashkrimit në vitin 2006, përsëri kërkesa e paditësit rezulton

të jetë parashkruar. Nën supozimin se ka pasur pohim borxhi ne vitin 2006 parashkrimi ka filluar të rrjedhë përsëri me datën 01.01.2007. Megjithatë, kërkesa do të parashkruhej pas tre viteve më 01.01.2010, gjersa kërkesa kërkesa kreditore është paraqitur tri vite më vonë, përkatësisht në vitin 2013.

Po ashtu edhe pretendimi i paditësit se me letër pezullim punëtoret ishin njoftuar që kërkesa tyre mund t'i parashtrojnë pranë AL-së, kur të fillojë procedura e likuidimit është i pa bazuar dhe i pa argumentuar. Shkalla e I-rë me të drejtë ka konstatuar që nuk i ka marrë për bazë këto pretendime, sepse AKP-ja asnjëherë nuk e ka konsideruar paditësin si kreditorë, nuk ka komunikuar me të dhe nuk i ka dhënë dëshmi njoftimi se NSH-ja është privatizuar apo se duhet pritur fillimin e procesit të likuidimit për të deponuar kërkesën kreditore. Edhe Kolegji i Apelit vëren se paditësi tenton ta përdor këtë pretendim si argument të ndërprerjes së aftit të parashkrimit të kërkesës kreditore.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi, nuk ka arritur t'i provojë me asnjë provë se ai ka parashtruar kërkesë në Gjykatë apo në ndonjë Autoritet kompetent brenda tre viteve, në atë mënyrë që kërkesa e tij të mos jetë parashkruar.

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të drejtën materiale, andaj i konsideron si të pathemelta pretendimet e paditësit se nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë dispozita ligjore.

Kolegji i Apelit i mbështet të gjeturat faktike të Shkallë të I-rë dhe konstatimet e dhënë në Aktgjykimin e ankimuar, pasi që ato i konsideron e si të drejta dhe të bazuara në ligj.

Prandaj duke u bazuar në këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore më 19 dhjetor 2022 komfor nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, andaj nuk ngarkohet me taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 18 prill 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____